



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.298/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 04.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.298/2025, e datës 01.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025, PZAP- ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se me datë 31 janar 2025, në ora 1 8: 1 4/h, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ish kandidatë për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ka publikuar një postim në profilin e tij në rrjetin social Facebook, me tekst shoqërues : *"Kurrë mos harroni të kaluarën shumë të afërt. Koha kur të fortit e PDK të eliminonin fizikisht për mendimin ndryshe, siç na kishte treguar vetë viktima e këtij rasti, Gazmend Halilaj. këta të fortë vazhdojnë të kenë fuqinë e padiskutueshme brenda partisë kryesore opozitare, dhe të gjithë në këtë Parti i përulën ose nuk guxojnë të hapin gojën ndaj të njëjtëve."* ku përveç tjerash, shihen edhe disa fotografi të publikuar, ku shihen disa lecka me gjak dhe disa persona tek gjuhen me armë, duke aluduar se anëtar të PDK, e kanë realizuar një krim të tillë, gjuhë kjo e cila përbën nxitje të përçarjes, urrejtjes, dhunës dhe përçmimit ndaj anëtarëve. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë Postimin e publikuar në profilin e z. Driton Vela në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/driton.vela/posts/pfbid0BcglC5xGgpx8v3hcaflMPvLjuGNqe5LwMhDvKRnRmcFbvidM5tqzxVbphNQ75gtfl>; e subjektit të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe Screenshoot nga postimi i z. Driton Vela, në të cilën dëshmohet data dhe koha e publikimit të postimit me tekst shoqërues, e cila përmban gjuhë të urrejtjes dhe nxitjes; 012PDK vlerëson se në veprimet e z. Driton Vela janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 34, par. 1, nën paragrafi 1 . 1 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë Anr.298/2025, të datës 03.02.2025, theksohet se ankesa është e pa bazuar për arsye se, në asnjë moment subjekti ankues nuk ka arritur të vërtetojë që personi z. Driton Vela është përkrahës i Lëvizjes tonë.

Personi në fjalë ka qenë pjesë e listës tonë në vitin e largët 2019 dhe mik do të thotë se i njëjti duhet patjetër të mos ndërroj qëndrimet e tij politike asnjëherë, njëherë Vetëvendosje mik do të thotë gjithmonë Vetëvendosje, pasi që bindjet politike janë të garantuara që të zgjedhën lirshëm. Për më tepër nga provat e bashkangjitura nuk ka ndonjë provë relevante që e dëshmon të kundërtën, Madje nga postimet e z. Driton Vela që janë publike për të gjithë, lehtësisht mund të verifikohet se i njëjti në këtë fushatë zgjedhor nuk ka postuar asgjë për zgjedhjet e 9 shkurtit për përkrahjen e Lëvizjes VETËVENDOSJE. Postimet e tij lidhën kryesisht me botën akademike dhe me analiza lidhur me gjendje socio ekonomike në Kosovë, andaj kategorizimi si mbështetës i Lëvizjes tone nuk qëndron.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, dhe vlerësimit të përgjigjes në ankese ka gjetur se shprehjet e përdorura ne rrjetin social Facebook nga personi me emrin Driton Vela, nuk mund të vërtetohet se i njëjti është kandidat apo mbështetës i subjektit politikë LVV.


Paneli ka gjetur se qëndron fakti se gjate vitit 2019, personi me emrin Driton Vela ka qene pjese e listës se subjektit politik LVV – së, mirëpo se fundmi nuk ka prova se i njëjti është mbështetës i këtij subjekti apo se është i angazhuar ne aktivitete zgjedhore të subjektit politik në fjale.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankese dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të provoj se personi Driton Vela është mbështetës i LVV andaj si të tilla këto pretendime i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.298/2025 më datë 04.02.2025

Kryesuese e Panelit
Kymetë Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.